

Komandanti i KFOR-it, vizitoi gjimnazin "Loyola" në Prizren

Bühler vlerësoi gjimnazin "Loyola" për sukseset në arsimin parauniversitar

KOHA
LITON

RAMADAN BARALIU

PRIZREN, 21 DHJETOR – Komandanti i KFOR-it, gjermani Erhad Bühler të martën ka vizituar gjimnazin "Loyola" në Prizren që financohet pjesërisht nga shteti gjerman. Ai e ka vlerësuar si shumë të suksesshëm këtë institucion të arsimit të mesëm, dhe ka siguruar se KFOR do të vazhdoj ta mbështes edhe në të ardhmen. Bühler ka pohuar se ky gjimnaz në shtetin nga vjen ai gëzon imazh pozitiv. "Kjo shkollë pjesërisht financohet nga Gjermania, mirëpo gjatë kësaj vizite vërejtja pse gëzon këtë imazh të madh dhe që mund të cilësohet si një ndër shkollat më të mira dhe më të suksesshme në Kosovë. Ne patëm kënaqësinë të përjetojmë edhe njëherë mikprit-

jen, miqësinë dhe ambiciet e mëdha që tregojnë nxënësit në këtë shkollë. KFOR-i e ka mbështet këtë shkollë pesë vite me radhë dhe e sigurova Atin Walter Happel që do ta ndihmojmë edhe në të ardhmen, sepse në të vërtetë është një investim për të ardhmen e Kosovës dhe që duhet ta bëjmë patjetër", ka thënë komandanti i KFOR-it, pas vizitës që i ka bërë drejtorit të kësaj shkolle, ati Walter Happel. Ndërkaq ky i fundit ka thënë se çelësi i suksesit të këtij gjimnazi është angazhimi maksimal në punë të stafit. "Çelësi i suksesit është angazhimi i nxënësve, edukatorëve dhe mësimitdhënësve. Ky angazhim është i ndërlidhur me një mësimitdhënie të besueshme dhe çështja është që

nxënësit tanë kanë për të absorbuar një kurrikulum të gjerë. Nuk do të thotë që këtu mësohet vetëm shkrim dhe leximi, por përveç lëndëve të zakonshme si edhe në shkollat tjera, këtu prej klasës së gjashtë kemi 5 orë të gjuhët latine dhe gjermane. Kemi trajnime të rregullta të mësimitdhënësve tanë.

Dëshira dhe detyrimi ynë është t'u ndihmojmë fëmijëve të Kosovës. Natyrisht jemi të gatshëm për bashkëpunim kudo që janë të nevojshme dhe të mundshme", ka theksuar ati Welter Happel. Gjimnazi i tipit konviktor "Loyola" filloi punën pesë vjet më parë, ndërsa aktualisht mësimet i ndjekin afër 600 nxënës, jo vetëm nga rajoni i Prizrenit, por nga edhe nga vise të tjera të Kosovës.